

MANUAL PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN

NDËRGJEGJËSIMI I VOTUESVE PËR HERË TË PARË

*Voto për vete!
Voto për ne!*

2017

Botim i Akademisë së Studimeve Politike në kuadër të programit “Ndërgjegjësimi i votuesve për herë të parë të zgjedhjeve për Kuvend”

Ky botim financohet nga Këshilli i Evropës dhe
Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Të dashur të rinj

Ky manual informues u drejtohet të gjithë të rinjve që votojnë për herë të parë në zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin e Shqipërisë. Nëpërmjet këtij botimi shpresojmë që ju të njihni më mirë jo vetëm procedurën e votimit, por njëkohësisht edhe rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë proces dhe vendosur për të mandatuar kandidatët që do të përfaqësojnë zërin dhe vullnetin tuaj. Pra, drejtuesit politikë që do të marrin vendime që ndikojnë në mirëqënien tuaj dhe të komunitetit ku banoni.

Nëse i kushtoni vetëm 4 minuta leximit të kësaj broshure, do të keni mundësinë që të mendoheni më mirë përpara se të vendosni për 4 vitet e ardhshme të zhvillimit të vendit.

Permbajtja

Shqipëria jonë	5
Fuqia ime e ndryshimit	6
Për çfarë do votoj ?	8
Sistemi zgjedhor që përdorim	9
Ku do të votoj?	11
Procesi i votimit	14
Si mund të votojmë	16
Përgjegjësitë dhe sanksionet	19
Parimet e përgjithshme të zgjedhjeve	22

I. Shqipëria jonë

Shqipëria njihet zyrtarisht si Republika e Shqipërisë që nga viti 1992. Shqipëria është anëtare e Kombeve të Bashkuara, NATO-s, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Këshillit të Evropës, Organizatës Ndërkombëtare të Tregtisë, Organizatës së Konferencës Islamike dhe një nga anëtarët themeluesë të Bashkimit për Mesdheun.

Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi lëvizjen e lirë pa viza në Zonën Shengen për qytetarët shqiptarë më 8 nëntor 2010 që hyri në fuqi më 15 dhjetor 2010. Që nga 24 Qershori 2014 Shqipëria ka marrë zyrtarisht statusin e “vendit kandidat” për të qënë pjesë e Bashkimit Evropian.

Republika e Shqipërisë është demokraci parlamentare e themeluar në bazë të kushtetutës së rinovuar në vitin 1998 me referendum popullor, duke garantuar kështu shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut e lirinë fetare.

Zgjedhjet për Kuvend mbahen çdo katër vjet për një parlament me 140 vende, i njohur zyrtarisht si Kuvendi i Shqipërisë. Zgjedhjet për Pushtetin Vendor mbahen gjithashtu çdo katër vjet për të përcaktuar drejtuesin e bashkisë dhe anëtarët e këshillit bashkiak.

Zgjedhjet e 22 marsit 1992 konsiderohen si zgjedhjet e para plotësisht demokratike në historinë e Shqipërisë që prej themelimit të saj si shtet i pavarur. Demokracia është normë tashmë dhe pothuajse përbën një vlerë morale në rajon e duhet konsideruar si një proces që kërkon më shumë se mbajtja e zgjedhjeve.

Demokracia përfshin parimet që vijojnë: rregullat, institucionet dhe procedurat që sigurojnë përfaqësim e përgjegjshmëri dhe mbrojnë



individin apo grupet kundrejt sjelljeve arbitrare, padrejtësisë ose dhunën e ushtruar nga Shteti apo aktorë të tjerë.


Një sistem demokratik gjithashtu duhet të japë mundësi për qytetarët që të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e shoqërisë. Roli i shoqërisë civile, grave dhe të rinjve në demokratizim, si dhe nevoja themelore për një ndryshim paqësor të udhëheqësve në pushtet, përbëjnë një faktor thelbësor për konsolidimin e demokracisë.

II. Fuqia ime e ndryshimit

Demokracia është sistemi qeverisës që kemi vendosur të ndjekim që prej dhjetorit 1990. Demokracia përfshin parimet që vijojnë: rregullat, institucionet dhe procedurat që sigurojnë përfaqësim e përgjegjshmëri si edhe mbrojnë individin apo grupet kundrejt sjelljeve arbitrare, padrejtësisë ose dhunën e ushtruar nga Shteti apo aktorë të tjerë.

Vetë fjala demokraci do të thotë: sundim i popullit. Pra, qytetarët marrin në dorë fuqinë e votës dhe nëpërmjet saj mandatojnë qeveritarët e tyre qendrore apo ata vendorë në qytetin apo fshatin e tyre. Nëse këta të zgjedhur nuk i shërbejnë si duhet interesave të qytetarëve, atëherë populli i dënon ata me votë kundër në zgjedhjet e ardhshme. Ky është parimisht sundimi i popullit dhe fuqia e zgjedhjeve të lira.

Sidoqoftë, demokracia duhet konsideruar si një proces që kërkon më shumë se vetëm mbajtja e zgjedhjeve. Ka shumë raste në histori, që qeveri të dalë nga zgjedhje të lira dhe vullneti i qytetarëve, pas ardhjes në pushtet i kanë kufizuar liritë e tyre. Si garanci që këta qeveritarë të mos “rëshkasin” nga këto norma të përcaktuara të demokracisë, shërbejnë funksionimi i ligjit, institucionet e pavarura që zbatojnë ligjin, mediat dhe shoqëria civile.



Nëpërmjet krijimit të këtyre kushteve për kontroll dhe transparencë të drejtpërdrejtë, qytetarët sigurojnë njëkohësisht një qeverisje të mirë, që respekton interesat e tyre dhe zhvillon politika zhvillimi ekonomike dhe sociale që i përgjigjen kërkesave të shoqërisë.

Në këtë aspekt, zgjedhjet për Kuvendin janë të rëndësishme, pasi ato krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet votuesve dhe përfaqësuesit të zgjedhur.

III. Për çfarë do votoj ?

Zgjedhjet për Kuvend do të përcaktojnë deputetët si përfaqësues të qytetarëve. Njëkohësisht, partia apo koalicioni që fiton nga zgjedhjet më shumë se gjysma e mandateve të deputetëve të Kuvendit (70 + 1 mandate) cilësohet si mazhoranca qeverisëse, ndërsa forcat e tjera si opozita.

Mazhorancës i lind e drejta që të formojë qeverinë dhe të ushtrojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga pushteti ekzekutiv dhe kanë ndikim në jetën e përditshme të çdo qytetari. Duke risjellë në vëmendje këtë fakt mjaft të rëndësishëm, duhet të vendosim me më shumë përgjegjësi për të marrë pjesë në këtë proces si edhe për të zgjedhur forcën politike të duhur. Kjo e drejtë u jepet qytetarëve vetëm një herë në katër vite dhe ata duhet ta shfrytëzojnë me përgjegjësinë e duhur këtë mundësi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni i mandatuar nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili ka për detyrë të organizojë të gjithë procesin zgjedhor si edhe të shpallë rezultatin e zgjedhjeve dhe mandatojë deputetët. Gjithashtu KQZ ushtron kontrollin mbi financimet e fushatës zgjedhore, shqyrton dhe zgjidh ankesat e subjekteve zgjedhore për

zhvillimin e procesit zgjedhor si dhe vendos sanksione administrative kundër personave, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet, si dhe bën kallëzim penal për vepra penale në lidhje me zgjedhjet. Të drejtat dhe detyrat e KQZ përcaktohet nga ligji themelor i zgjedhjeve, apo ndryshe i quajtur Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

IV. Sistemi zgjedhor që përdorim

Shqipëria ka zgjedhur sistemin proporcional rajonal të përfaqësimit për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin. Vendi është ndarë në 12 zona zgjedhore, që përkrijnë me ndarjen territoriale të qarqeve dhe në secilën



Nr.	Qarku/ zona zgjedhore	Mandate
1	Berat	7
2	Diber	6
3	Durres	14
4	Elbasan	14
5	Fier	16
6	Gjirokaster	5
7	Korce	11
8	Kukes	3
9	Lezhe	7
10	Shkoder	11
11	Tirane	34
12	Vlore	12
	Totali	140

prej këtyre zonave është përcaktuar një numër i caktuar mandatesh. Numri i deputetëve për çdo qark/ zonë zgjedhore përcaktohet në përpjestim me numrin e banorëve të tij dhe në këtë mënyrë çdo deputet përfaqëson një numër të përafërt qytetarësh në të gjitha qarqet. Kjo është lista e shpërndarjes së mandateve në qarqe:

Subjekte zgjedhore mund të jenë:

- Parti politike
- Koalicion partish politike
- Kandidat i propozuar nga një grup votuesish

Subjektet zgjedhore duhet të paraqesin përpara ditës së votimit, një listë shumëemërore të kandidatëve të përcaktuar prej tyre në secilin zonë zgjedhore (qark) të vendit. Në përfundim të votimit, mbi bazën e votave të marra për secilin subjekt, bëhet edhe shpërndarja e mandateve për kandidatët e listës së paraqitur. Një formulë matematikore e quajtur “Formula d’Hondt”, përcakton ndarjen e mandateve mes subjekteve të ndryshme, ndërkohë që formula tjetër “Saint Laguerre”, përcakton ndarjen e mandateve mes vetë partive që përbëjnë koalicionin.

Që prej vitin 2009, Kodi Zgjedhor detyron subjektet që për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë përqind e listës shumëemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Ky rregull synon që të krijojë mundësinë e përfaqësimit sa më të drejtë të kandidatëve të gjinisë femërore në lista zgjedhore dhe më tej në Kuvend. Gjithashtu, ndryshimet e Kodit Zgjedhor në vitin 2015 detyrojnë partitë politike në zgjedhjet vendore që 50 përqind e listës së këshillave bashkiakë t’i përkasë gjinisë femërore.

V. Ku do të votoj?


Çdo qytetar shqiptar që ka mbushur 18 vjeç deri në ditën e votimit (duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve), ka të drejtë për të votuar e për t'u zgjedhur, pavarësisht nga raca, etniciteti, gjinia, gjuha, bindja politike, besimi fetar, aftësitë fizike, apo kushtet ekonomike.


Autoritet vendore kanë detyrimin që t'iu njoftojnë paraprakisht me shkrim në lidhje me qendrën e votimit, vendndodhjen e saj, adresën, si dhe numrin rendor të votuesit në listën e votuesve.

Pavarësisht nga ky detyrim, përpara ditës së votimit duhet të siguroheni që emri juaj gjendet në listat e votimit të shpallura publikisht në ambientet publike pranë njësisë suaj të banimit apo nëpërmjet internetit në faqet online www.cec.org.al dhe www.punetebrendshme.gov.al



Në rast se ju nuk e gjeni emrin tuaj në listat e publikuara apo identiteti juaj ka pasaktësi, duhet të njoftoni Zyrën e Gjendjes Civile të zonës tuaj. Gjithashtu ju keni të drejtë të paraqisni një kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore.







VI. Procesi i votimit

Paraqitja në qendrën e votimit

Qendrat e votimit hapen në orën 700 dhe mbyllen në orën 1900. Askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes së qendrave të votimit, me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes.

Votuesit i lejohet të votojë vetëm me prezantimin ose të Kartës së Identitetit, ose Pasaportës së Vlefshme në Komisionin e Qendrës së Votimit.

Votuesi do të kontrollohet në të dyja duart për shenjën e bojës së posaçme që përdoret në votim nga një anëtar i Komisionit të Qendrës së Votimit (që është caktuar me këtë detyrë)

Votuesi nënshkruan në listën e votuesve përbri emrit të tij të plotë Pasi i vendoset shenja me bojën e dukshme në dorë, votuesit i jepet fleta e votimit. (Sigurohuni që fleta juaj e votimit të jetë vulosur me të

		FLETË VOTIMI				
		Zgjedhjet për Kuvendin, 19.06.2017				
QARKU _____ ZAZ Nr. _____					[Barcode]	
QV Nr. _____		SUBJEKTET ZGJEDHORE			[Ballot Marking Area]	
KOALICIONI I PROPOZUAR	1	<input checked="" type="checkbox"/> ALXXCVBMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDSA	EMRI MBIEMRI	ALX	1	
	2	<input checked="" type="checkbox"/> BMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDSA	EMRI MBIEMRI	BML	2	
	3	<input checked="" type="checkbox"/> XXXCVBMLPNJKLFDREPUTSERKLP	EMRI MBIEMRI	XCV	3	
	4	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA XCVBMLPNJKLFDREPU	EMRI MBIEMRI	PXVBF	4	
	5	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA ABMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDSA	EMRI MBIEMRI	PABFDS	5	
	6	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA BMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDS	EMRI MBIEMRI	PBPN	6	
	7	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA BBMLPNJKLFDREPUTSERKL	EMRI MBIEMRI	KLQRP	7	
	8	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA BLFDREPUTSERKLPERTFDSA	EMRI MBIEMRI	UTS	8	
	9	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE	EMRI MBIEMRI	NJKL	9	
	10	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA DFDREPUTSERKLPERTFD	EMRI MBIEMRI	PFGS	10	
	11	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA E BMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDSA	EMRI MBIEMRI	PUTRE	11	
	12	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA FOBMLPNJKLFDREPUTSERKLP	EMRI MBIEMRI	TSE	12	
	13	EMËR ATËSIA MBIEMËR	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT		13	
	14	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA ORBMLPNJKLFDREPUTSERKLPERT	EMRI MBIEMRI	YY	14	
	15	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA PËBMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFD	EMRI MBIEMRI	AA	15	
	16	EMËR ATËSIA MBIEMËR	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT		16	
KOALICIONI I COPITËF	17	<input checked="" type="checkbox"/> LËVIZJA PËBMLPNJKLFDREPUTSERKLPERT	EMRI MBIEMRI	GG	17	
	18	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA BABMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDSA	EMRI MBIEMRI	JJK	18	
	19	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA DEBMLPNJKLFDREPUTSERKL	EMRI MBIEMRI	TT	19	
	20	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA E REBMLPNJKLFDREPUTSERKLPQE	EMRI MBIEMRI	SS	20	
	21	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA KOBMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDSA	EMRI MBIEMRI	QQ	21	
	22	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA RBMLPNJKLFDREPUTSERKLP	EMRI MBIEMRI	LL	22	
KOALICIONI I PROPTREKOSI	23	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA PËBMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTF	EMRI MBIEMRI	NN	23	
	24	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA BMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFD	EMRI MBIEMRI	NN	24	
	25	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA E BMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDSA	EMRI MBIEMRI	GKS	25	
	26	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA PËBMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDSA	EMRI MBIEMRI	OO	26	
	27	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA SBMLPNJKLFDREPUTSER	EMRI MBIEMRI	HH	27	
	28	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA TOBMLPNJKLFDREPUTSERKLPER	EMRI MBIEMRI	WW	28	
KOALICIONI I LORE	29	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA BASBMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDS	EMRI MBIEMRI	AQWE	29	
	30	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA DEBMLPNJKLFDREPUT	EMRI MBIEMRI	UTR	30	
	31	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA BMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDS	EMRI MBIEMRI	PJG	31	
	32	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA SOCBMLPNJKLFDREPUTSERKLPERT	EMRI MBIEMRI	FFOR	32	
	33	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA SOBMLPNJKLFDREPUTSERKLP	EMRI MBIEMRI	TSJ	33	
	34	EMËR ATËSIA MBIEMËR	KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT		34	
	35	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA E BMLPNJKLF	EMRI MBIEMRI	ZYS	35	
	36	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA BMLPNJKLFDREPUTSERKLPERTFDSAVBASD	EMRI MBIEMRI	JKDU	36	

*Modeli i
fletës së
votimit*

Zgjedhësi shënon në krah të emrit të subjektit zgjedhor apo partisë pjesëtare të një koalicioni shenjë “x” ose “+” apo një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij.

dyja vulat e komisionit në pjesën e pasme të saj).

VIII. Si mund të votojmë

Duke qëndruar i vetëm në dhomën e fshehtë të votimit, zgjedhësi shënon në krah të emrit të subjektit zgjedhor apo partisë pjesëtare të një koalicioni shenjën “x” ose “+” apo një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Duhet patur kujdes që shenja të jetë brenda kuadratisht bosh të parashikuar përkrah subjektit.

Zgjedhësi palos fletën në kabinën e votimit me qëllim që të mos shihet për cilin është votuar, por të paktën një nga vulat në pjesën e pasme të fletës të jetë e dukshme.

Zgjedhësi shkon për të depozituar fletën e votimit në kutinë e votimit dhe del më pas nga qendra e votimit.

Nëse fleta e votimit plotësohet jashtë kabinës së votimit, votuesit nuk i lejohej të depozitojë fletën e votimit në kuti dhe ajo do të quhet e PAVLEFSHME. Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletë votimi tjetër e të njëjtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, atij nuk i jepet më fletë votimi.

Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe zgjedhësit i jepet një fletë votimi e dytë. Nëse e përsërit këtë kërkesë për herë të dytë, atij nuk i jepet më fletë votimi.

Zgjedhësit më aftësi të kufizuara

E drejta e votimit iu garantohet detyrimisht edhe personat me aftësi të kufizuara fizike. Në këtë rast:



1. zgjedhësi mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.
2. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
3. Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.
4. Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në dhe kjo e fundit pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi që i lejojnë ata të votojnë në mënyrë të pavarur. Në rast të kundërt, këta zgjedhës mund të shfrytëzojnë të drejtën për t'u asistuar sipas procedurës së mësipërme për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.



VIII. Mos lejo të tjerët të vendosin për ty!

Zhvillimi i një shoqërie demokratike në Shqipëri ende nuk është i plotë. Një problem i vazhdueshëm është 'votimi familjar' në të cilin një pjesëtar i familjes – zakonisht bashkëshorti – vendos ose ndikon zgjedhjen e votimit për pjesëtarët e familjes.

Kjo ndodh nëpërmjet:

- Votimit në grup (hyrja në kabinën e votimit së bashku me pjesëtarë të tjerë të familjes),
- Votimit të hapur (grupet familjare votojnë së bashku hapur) dhe
- Votimit të deleguar (marrja e fletëve të votimit 'në emër' të pjesëtarëve të familjes).

Votimi i fshehtë përbën një tipar themelor të procesit demokratik. Kjo praktikë ndikon në të drejtën për të shprehur vullnetin individual si qytetarë dhe kryesisht prek gratë. E drejta për të zgjedhur me votim të fshehtë i përket çdo individ dhe është e parashtruar në ligj.

Një tjetër fenomen i kufizuar, por mjaft i dëmshëm është dhe shitja dhe blerja e votës së qytetarëve. Duke pranuar një shpërblim të vogël financiar, qytetarët humbasin mundësinë për të sjellë ndryshim me votën e tyre. Për fat të keq, ky fenomen i shitblerjes së votës ndikon edhe në shtrembërimin e rezultatit të zgjedhjeve dhe forcën e votës së të gjithë qytetarëve të tjerë për të ndryshuar partitë dhe udhëheqësit politikë në pushtet.

***Ndikoni që në familjen tuaj të mos votohet në grup,
apo të mos delegohet dhe shitet vota, por secili prej
pjesëtarëve të shprehet lirshëm për vullnetin e tij.***

IX. Përgjegjësitë dhe sanksionet

Pjesëmarrja në zgjedhje është një e drejtë, por njëkohësisht për bën edhe një përgjegjësi. Nëse zgjedhësit shkelin detyrimet apo bëhen pjesë e veprimeve, të cilat synojnë shtrembërimin e rezultatit të zgjedhjeve,

atëherë ata rrezikojnë që të bëhen subjekt i ndëshkimeve të parashikuara si më poshtë vijon:

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Falsifikimi i Dokumenteve (Neni 186)

Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara është e dënueshme me burgim deri në tre vjet ose me një gjobë nga 200,000 deri në 600,000 lekë. Kur kjo vepër penale kryhet në bashkëpunim me shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja serioze, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe me një gjobë nga 300,000 deri në një milion lekë. Kur falsifikimi bëhet nga një person që ka detyrë nxjerrjen e dokumenteve, dënimi është burgim nga një deri në shtatë vjet dhe me një gjobë nga 500,000 deri në 2 milionë lekë.

Kur vepra e falsifikimit të dokumenteve kryhet nga personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor (komisionerë dhe numërues) ajo dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet dhe me gjobë nga 300 mijë deri në 600 mijë lekë.

Shkelja e fshehtësisë së votës (Neni 327)

Shkelja e fshehtësisë së votës nga persona përgjegjës për zgjedhjet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë deri në një vit burg.

Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve (Neni 328)

Ofrimi ose dhënia e parave, në çfarëdo forme, me synim [...] votimin për ose kundër një kandidati ose për marrjen pjese apo mosmarrjen pjesë në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë deri në

gjashtë muaj burgim. Pranimi i parave, premtimeve apo favoreve të tjera për të kryer veprimet e mësipërme, përbën shkelje penale dhe dënohet me gjobë.

Kanosja e zgjedhësit (Neni 329)

Kanosja e një zgjedhësi për të votuar në favor të apo kundër një kandidati, për të marrë pjesë ose për të mos marrë pjesë në zgjedhje përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë deri në dy vjet burgim.

Ligji Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

Votimi më shumë se një herë (Neni 169 KZ)

Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose heqje lirie deri në tre muaj.

Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve (Neni 170 KZ)

Braktisja e detyrës, pa shkaqe të ligjshme, nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve, anëtarët e grupeve të numërimit apo vëzhguesit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose heqje lirie nga 2 deri në 5 vjet.

X. Parimet e përgjithshme të zgjedhjeve

Disa parime për cilësimin e zgjedhjeve demokratike janë:

Universaliteti – çdo qytetar shqiptar që ka mbushur 18 vjeç, duke përfshirë edhe Ditën e Zgjedhjeve, ka të drejtë për të votuar e për t'u zgjedhur, pavarësisht nga raca, etniciteti, gjinia, gjuha, bindja politike, besimi fetar, aftësitë fizike, apo kushtet ekonomike.

Fshehtësia – fshehtësia e votës është e mbrojtur. Zgjedhjet duhet të mbahen pa ushtrim force dhe frikësimi. Nëse votuesi përballet me çdo lloj imponimi gjatë procesit të votimit, fleta e votimit do të quhet e PAVLEFSHME.

Të lira – njerëzit duhet të krijojnë vetë mendimin e tyre duke u informuar nëpërmjet mekanizmave ndërgjegjësuese, kandidatëve që kandidojnë dhe partive politike.

Neutrale – nevojitet një media e paanshme dhe e lirë gjatë procesit të fushatës zgjedhore të kandidatëve. Liria e mbledhjes, liria e shprehjes dhe mendimit të kandidatëve e partive politike duhet të rregullohen nga shteti nëpërmjet mekanizmave të paanshme.

Të ekuilibruara – financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore, mbulimi i tyre i paanshëm nga media, sigurimi i ndarjes së partisë nga Shteti; krijimi i kushteve për konkurim në zgjedhje legjislative në kushte të barabarta, akses në pushtet dhe ushtrimi i tij në përputhje me shtetin e së drejtës.

Barazia – Barazi për të gjithë qytetarët –Çdo votë është e barabartë.

Çdo votues ka të drejtën vetëm të një vote për zgjedhje të një subjekti elektoral apo kandidati.

Të drejtëpërdrejta – cilido votues duhet të shprehë lirshëm vullnetin e tij/saj për një subjekt elektoral duke e shënuar atë në fletën e votimit pa asnjë detyrim.

Mbi të gjitha mos harroni: Ditën e zgjedhjeve keni një takim të rëndësishëm. Një takim me të ardhmen.

Për më tepër informacion dhe praktikimin e dijeve tuaja mbi procesin e votimit, drejtohuni në faqen tonë të internetit: www.zgjedhjet.asp.al

Gjithashtu mund të shkarkoni online aplikacionin e ndërtuar në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për celularët smartphone, ku mund të informoheni në kohë reale me informacione mbi procesin e votimit, vendndodhjen e qendrës tuaj të votimit si dhe denonconi parregullsi dhe abuzime që mund të hasni ditën e zgjedhjeve.